REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-1370
Dt.12.02.2018

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e Republikës së Kosovës,** për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për vendosjen - ndërtimin e objektit të Stacionit Meteorologjik (të tipit shtyllë), në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET: aplikuesit: Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimi Hapësinor, Republika e Kosovës, ndërtimi – vendosja e objektit të Stacionit Meteorologjik, të tipit shtyllë, në ngastrën kadastrale me numër 107/0, ZK: Skivjan, në pronësi (e ndarë për ndërtimin e Impiantit – Fabrikës për përpunimin dhe pastrimin e ujërave të zeza, bazuar në Vendimin me numër 01 Nr. 011-3331/2009 datë 29.05.2009), e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në Ekstraktin e Lokacionit të gjëre me qasje në rrugën regjionale R107 (Gjakovë-Pejë) për vendosjen e Stacionit Meteorologjik në Kuadër të parcelës kadastrale me numër 1021/0, ZK:Skivjan, të lëshuar nga DUMM.

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është:

- **Pëlqimi Parimor, me nr.07-353/01-1370, dt.29.01.2018, së bashku me Ekstraktin e Lokacionit të gjëre me qasje në rrugën regjionale R107 (Gjakovë-Pejë) për vendosjen e Stacionit Meteorologjik në Kuadër të parcelës kadastrale me numër 1021/0, ZK:Skivjan, të lëshuar nga DUMM.**
- **Vendimi nga K.K.Gjakovë, me nr. 01.nr.011/01-3331/2009.**
- **Rekomandimet, dhe sygjerimet e pranuara përmes post•s elektronike (emailit) nga MMPH.**

III. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë për Punë Inspektuese, për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit të lokacionit të piketuar.

IV. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e Republikës së Kosovës, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM-së, me nr. 07/351/01-1370, të datës 25.01.2018 për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për vendosjen - ndërtimin e objektit të Stacionit Meteorologjik (të tipit shtyllë), në ngastrën kadastrale me numër 107/0, ZK: Skivjan, në pronësi (e ndarë për ndërtimin e Impiantit – Fabrikës për përpunimin dhe pastrimin e ujërave të zeza, bazuar në Vendimin me numër 01 Nr. 011-3331/2009 datë 29.05.2009, siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. **Pëlqimi Parimor, me nr.07-353/01-1370, dt.29.01.2018, së bashku me Ekstraktin e Lokacionit të gjëre me qasje në rrugën regjionale R107 (Gjakovë-Pejë) për vendosjen e Stacionit Meteorologjik në Kuadër të parcelës kadastrale me numër 1021/0, ZK:Skivjan, të lëshuar nga DUMM.**
2. **Vendimi nga K.K.Gjakovë, me nr. 01.nr.011/01-3331/2009.**

I liruar nga taksa administrative, në bazë Nenit 5, parafgrafi 5.15. nënparagrafi b), të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, me nr. 01 Nr.011-43964/2015, dt.30.06.2015.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:
- **Investitorit,**
- **Drejtorisë së Inspekcionit ,**
- **Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,**
- **Arkivit.**

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani, jur.dipl.

D r e j t o r i

Arben Bakalli, jur. i dipl.

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GJAKOVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Firzë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m2
P-70705077-00107-0	Pracelë / Parcela / Parcel	81132,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:4466

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.02.2018

Koha/ Vreme/ Time: 11:06:34

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: MCO GJAKOVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture: